



REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA E KOSOVËS	
GOVERNMENT OF KOSOVA - QEVERIA E KOSOVËS	
OFFICE OF THE PRIME MINISTER - ZYRA E KRYEMINISTRI	
SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
No. Dreg. / No. Dreg. / No. Dreg. / No. Dreg. /	02.1.a
No. Dreg. / No. Dreg. / No. Dreg. / No. Dreg. /	955
No. Dreg. / No. Dreg. / No. Dreg. / No. Dreg. /	-3-
No. Dreg. / No. Dreg. / No. Dreg. / No. Dreg. /	17/09/2025
Prishtinë/a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Datë: 17.09.2025

Mbledhja e 269-të e Qeverisë së Republikës së Kosovës mbahet më 19.09.2025, në orën 09:00, ndërtesa e Qeverisë, salla P-31.

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e Ekstraktit të Procesverbalit dhe të Transkriptit të mbledhjes së 265-të dhe ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjeve: 266, 267 dhe 268 Elektronike/Korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës (ZKM)
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i "Projektit për zgjerimin e mihjes sipërfaqësore, për eksploatim të thëngjillit për prodhim të energjisë elektrike për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) Sh. A." (MMPHI)
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim për interes publik, të pronës së paluajtshme ish-shoqërore, që administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Z. K. Beroc II, Komuna Shtërpçë, për nevoja të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës (MMPHI)
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore, që menaxhohen dhe administrohen nga AKP-ja, shpronësimi i të cilave është i nevojshëm për realizimin e projektit "Ndërtimi i Qendrës për Sport dhe Kulturë" në Komunën e Ferizajt (MMPHI)
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore, të menaxhuara dhe të administruara nga AKP-ja, të cilat janë të nevojshme për realizimin e disa projekteve të Komunës së Gjakovës (MMPHI)
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme ish-shoqërore KBI "Progres", që menaxhohet dhe administrohet nga AKP-ja, për realizimin e projektit "Objekte Edukativo-Arsimore dhe Sportive" në Dushanovë, Komuna e Prizrenit (MMPHI)
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore të N. Sh. Industrisë së Mobilieve "Përparimi", si dhe të atyre private, për nevoja të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës (MMPHI)

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës së Subjektit Kërkues, Kompanisë KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A.), për shpronësim dhe krijimin e të drejtës së servitutit për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Linja ajrore 110kV, Parku me Erë - Zatriqi" (MMPHI)
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore për nevoja të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror: Z. K. Vrellë e Goleshit dhe Mirenë, Komuna e Lipjanit; Z. K. Zatriq, Komuna e Rahovecit; Z. K. Mramor, Komuna e Prishtinës dhe Z. K. Bajgorë, Komuna e Mitrovicës (MMPHI)
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Rehabilitimi, Zgjerimi dhe Asfaltimi i Rrugës Nacionale R-118, Segmenti brenda Fshatit Mushtisht", Komuna e Suharekës (MMPHI)
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Ndërtimi i Rrugës Korishë - Kabash - Lidhja me Rrugën Rajonale R118" (MMPHI)
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Përfundimtar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Ndërtimi i Ndërtesave të Banimit të Përbalueshëm dhe Social" për Komunën e Podujevës (MMPHI)
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Përfundimtar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i Projektit: "FLLOWS" i financuar nga Banka Botërore dhe Ndërmarrja Rajonale për Ujësjellës "Hidromorava" Sh. A., Z.K. Perlepnice, Komuna e Gjilanit (MMPHI)
14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Përfundimtar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Ndërtimi i Rrugës Rajonale R-118 Mushtisht - Shtërpçë" (MMPHI)
15. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Përfundimtar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Ndërtimi i Qarkores së Jashtme të Qytetit të Gjilanit dhe Kycja e Rrugës Nacionale N25.2 dhe N25.3 deri te Autoudha R7.1" (MMPHI)
16. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Preliminar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i projektit "Qarkorja e Vjetër e Qytetit të Gjilanit Llot 1 dhe Llot 2, Zonat Kadastrale Shillovë, Livoç i Ulët dhe Gjilan", Komuna e Gjilanit (MMPHI)
17. Shqyrtimi i kërkesës për transferimin e mjeteve buxhetore deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht për vitin 2025, për subvencionimin e blerjes së teksteve dhe materialeve mësimore për vitin shkollor 2025/2026 (MFPT)

18. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, datë 25.12.2022, lidhur me zbatimin nga Republika e Kosovës të pakove 15, 16, 17 dhe 18 të sanksioneve të Këshillit të Bashkimit Evropian, si dhe të masave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosjen e sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në lidhje me situatën në Ukrainë (MPJD)
19. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komisionit të Ankesave për të Huajt (MPB)
20. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për Aprovimin e ndarjes së mjeteve buxhetore për zbatimin e Masës 5 – Investimi në infrastrukturë dhe ambient të Pakos së Ringjalljes Ekonomike (MFPT)
21. Të ndryshme